



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**VLERËSIM MBI POLITIKAT RREGULLATORE PËR MBROJTJEN E
KLIENTËVE NË NEVOJË NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Punoi: Erjola Sadushi

Elton Rradheshi,

Julia Guga,

Brunilda Tavani

Agron Çomo,

Miglana Selimi,

Alba Malo

Miratoi : Bordi i ERE

Petrit Ahmeti – Kryetar

Raimonda Islamaj – Anëtare

Maksim Shuli - Anëtar

Petra Lika – Anëtar

Erjola Sadushi - Anëtare

Tabela

Hyrje

- 1. Varfëria energjitike dhe konsumatorët në nevojë në BE**
- 2. Varfëria energjitike dhe konsumatorët në nevojë në Palet Kontraktore te Traktatit të Komunitetit të Energjisë**
- 3. Faktoret që ndikojnë ne vlerësimin e varferise energjitike**
- 4. Krijimi i observatorit të varfërisë energjitike të Bashkimit European dhe Energy Advisory Hub**
- 5. Monitorimi i Varferise Energjitike**
- 6. Programet e Varferise Energjitike**
- 7. Komunitetet e Energjise per zbutjen e varferise energjitike**
- 8. Shqipëria dhe legjislacioni për konsumatorët në nevojë dhe varfërinë energjistik**
- 9. Rekomandime**
- 10. Konkluzione**

Hyrje

Përdorimi i energjisë është thelbësor për të siguruar një standard të përshtatshëm jetese dhe shëndeti. Në Europë, varfëria energjitike është një shqetësim në rritje që vë në rrezik shëndetin dhe mirëqenien e miliona qytetarëve. Sipas vlerësimeve të fundit, të publikuara nga Parlamenti European rezulton se rreth 36 milion qytetarë të Bashkimit European nuk mund t'i mbajnë shtëpitë e tyre të ngrohta në mënyrë adekuate.

Në nivel të BE-së, Komisioni European filloi të përfshijë mbrojtjen e konsumatorit dhe mbështetjen e konsumatorëve të varfër për qëllime të furnizimit me energji rreth 20 vjet më parë, e më pas duke futur në paketën e tretë të energjisë në 2009 konceptin e varfërisë energjitike, por duke ia lënë përgjegjësinë përfundimtare çdo shteti anëtar.

Megjithëse numri i vendeve që njohin konceptin e varfërisë energjitike zyrtarisht në legjislacion apo politikë po rritet, shumica e Shteteve anëtare nuk kanë ende një përkufizim zyrtar dhe ende ka mjaft diskutime që lindin në nivelin politikëbërës, për të adresuar konceptin shumëdimensional të varfërisë energjitike.

Varfëria energjitike kuptohet gjerësisht si *paafësia e familjeve për të mbajtur nivele të përshtatshme të shërbimeve të energjisë me një kosto të përballeshme*.

Janë një sërë faktorësh që përdoren për vlerësimin e treguesve që ndikojnë në nivelet e varfërisë së energjisë, të tilla si variacionet klimaterike, disponueshmëria e karburantit, lloji i stokut, performanca, kostot e larta të jetesës, etj. Shërbimet dhe ofruarit e energjisë, që mbajnë të dhëna të tilla, bëhen aktorët kryesorë për një orientim të drejtë të politikave.

Përkufizimi i varfërisë energjitike nuk është ende i harmonizuar në të gjithë Europën. Përgjithësisht, përkufizimi i varfërisë energjitike lidhet me pamundësinë për të siguruar shërbime të mjaftueshme të energjisë në shtëpi.

Varfëria energjitike është e lidhur me cënueshmërinë, e cila në kontekstin e diskursit të politikave të BE-së, *lidhet me aftësinë e kufizuar të familjeve për të aksesuar plotësisht përfitimet e ofruara nga tregjet e brendshme të energjisë.*

Sipas vlerësimit të KE-së për Planet Kombëtare të Klimës dhe Planet Energjitike të Klimës së integruar në vitin 2019 (NECPs), konstatohet se varfëria energjitike duhet të trajtohet në një mënyrë më të strukturuar nga Shtetet Anëtare, të cilët duhet të identifikojnë objektivat tregues për të reduktuar varfërinë energjitike të shoqëruar me grupet e synuara, politikat dhe masat përkatëse si dhe burimet e mundshme të financimit.

Ndërkohë që ka një mbivendosje në konceptet e konsumatorit në nevojë dhe varfërisë energjitike, është e rëndësishme të njihet varfëria energjitike si një çështje e veçantë. Duke qenë se të ardhurat janë një nga nxitësit e cënueshmërisë, ekziston një korrelacion midis konsumatorit në nevojë dhe varfërisë energjitike. Megjithatë, varfëria energjitike është një koncept më specifik, i cili i referohet marrëdhënies midis buxhetit të kufizuar të familjes dhe koston së energjisë. Varfëria energjitike është gjithashtu shumë e lidhur me varfërinë e përgjithshme. Familjet përballen me kosto shumë të ndryshme për të arritur të njëjtin nivel ngrohtësie për arsye të tjera përveç të ardhurave, të tilla si, efica energjitike e banesës ose aftësia e familjes për të bashkëvepruar me tregun. Përveç kësaj, një nivel i mjaftueshëm i energjisë është thelbësor për qytetarët.

Ky vlerësim, ka për qëllim të ofrojë një prezantim të përgjithshëm të asaj që është bërë tashmë në nivelin e BE, vendeve të Traktatit të Komunutetit të Energjisë si dhe në vendin tonë. Objektivi kryesor është të identifikohen dhe të vihet në dispozicion një informacion mbi eksperiencat deri më tani, mbi varfërinë energjitike, konceptin e përgjithshëm, dimensionet e saj, faktorët dhe mekanizmat mbështetës për zbutjen e varfërisë energjitike.

1. Varfëria energjitike dhe konsumatorët në nevojë në BE



Në nivel të BE-së, paketa Clean Energy - Energji e pastër për të gjithë Europeanët, miratoi një grup prej tetë aktesh legislative në lidhje me energjinë dhe konsumatorët europianë, me objektivi kryesor për të vënë eficaçen e energjisë në plan të parë, për të arritur lidhshpëri global në energjitë e rinovueshme dhe për të ofruar një marrëveshje të drejtë për konsumatorët.

Këto dokumente u botuan për herë të parë nga Komisioni Europian në nëntor 2016 dhe përfundoi me publikimin e teksteve përfundimtare të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian në qershor 2019, pas një dialogu ndërmjet Komisionit Europian, Këshillit dhe Parlamentit.

Paketa përfshin disa dispozita mbi varfërinë energjitike në Direktivat si vijon:

- Direktiva për Performancën Energjitike të Ndërtesave (EPBD) kërkon që veprimet përkatëse për të lehtësuar varfërinë energjitike, të përvijohen në strategjitë kombëtare të rinovimit dhe se ndërtesat më pak efikase duhet të jenë të parat në radhë për rinovim. Ajo kërkon që shtetet anëtare të promovojnë akses të barabartë në financa për rinovimin për të konsumatorët subjekt të varfërisë energjitike. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të zbatojnë kërkesat për një nivel të caktuar të performancës energjitike për pronat me qira.
- Direktiva për Eficiencën e Energjisë (EED) kërkon që një pjesë e masave, sipas nenit 7 (detyrimet e efikasitetit të energjisë ose masat alternative) të zbatohen midis familjeve të cënueshme, duke përfshirë ato të prekura nga varfëria energjitike. Investimet në rinovim, do të sjellin përfitime të shumëfishta, për familjet subjekt i varfërisë energjitike, si dhe për qëllimet e efikasitetit dhe klimës. Direktiva specifikon gjithashtu se, Shtetet anëtare duhet të krijojnë programe në nivel të Shteteve anëtare, që do të ofrojnë mbështetje financiare për masat e efikasitetit. Familjet subjekt i varfërisë energjitike duhet të kenë akses në këto skema.
- Direktiva e Energjisë Elektrike synon të ridizajnojë tregun e energjisë elektrike për të qenë më fleksibël dhe integruar më mirë i burimeve të rinovueshme të energjisë, si dhe për të siguruar që konsumatorët të mbrohen dhe të fuqizohen mirë në tregjet e energjisë elektrike në të gjithë Europën. Ata duhet të kenë akses në sisteme matje inteligjente dhe të mbrohen nga rritjet e çmimeve të energjisë elektrike. Neni 28, përmend nevojën që vendet të adoptojnë konceptin e klientëve në nevojë. Neni 29, kërkon që Shtetet anëtare të zhvillojnë një sërë kriteresh për të identifikuar familjet subjekt i varfërisë energjitike brenda vendeve të tyre, në mënyrë që të jenë në gjendje të ofrojnë mbështetjen e synuar. Shtetet Anëtare inkurajohen më tej të ndajnë praktikatat e mira për ta bërë këtë.
- Direktiva e Energjisë së Rinovueshme (RED) inkurajon aksesin në burime të rinovueshme për konsumatorët me të ardhura të ulëta dhe në nevojë, nëpërmjet masave me informacion në dispozicion të të gjithë konsumatorëve, përfshirë konsumatorët me të ardhura të ulëta dhe të pambrojtur. Në nenin 21 specifikohet se, barrierat e pajustificuara ndaj financimit duhet të adresohen për të lehtësuar aksesin. Komunitetet e energjisë së rinovueshme do të jenë të hapura për të gjithë konsumatorët si dhe do të zbatohen mjete për të lehtësuar aksesin në informacion dhe financim.
- Rregullorja e qeverisjes u kërkon Shteteve anëtare të identifikojnë nivelet e varfërisë energjitike dhe të përshkruajnë zgjidhjet për ta trajtuar këtë në planet e tyre Kombëtare të Energjisë dhe Klimës (NECP).

Prandaj, në nivel të BE-së, koncepti është përfshirë në shumë dispozita të të 5 akteve të sipërcituara.

Referuar ¹ studimit Heal 2019 të Komisionit Europian rezulton se:



Në vitin 2019, 15% e Europianëve jetonin në shtëpi me një çati të paizoluar, mure të lagësht, dysheme apo themel të pa termoizoluar. Kjo përqindje e lexuar në vlera, përfaqëson mbi 50 milionë njerëz. Për të patur një ide më të qartë të impaktit të sa më sipër, mjafton të ndërgjegjësohemi se deri në 100,000 Europianë vdesin çdo vit si rezultat i një shtëpie të ftohtë.

Në frymën e vlerësimit të të dhënave të mësipërme, për tu marrë në konsideratë në impaktin e varfërisë energjitike në popullatë, është patjetër dhe fakti që rreth 80 milionë njerëz në BE, rezultuan të ishin me vonesë ose nuk mund të paguanin faturat e tyre të shërbimeve në vitin 2019. Të dhënat e mësipërme janë rritur në mënyrë eksponenciale gjatë Covid19, ndërkohë që njerëzit ishin të izoluar në shtëpitë e tyre, qoftë për shkak të pamundësisë së sigurimit të energjisë elektrike, pamundësisë së shlyerjeve të detyrimeve për sigurimin e energjisë elektrike, por edhe mungesës së efieciencës në banesat e tyre për të garantuar nivelin minimal të kushteve që furnizimi me energji elektrike garanton.

Të dhënat ndërkombëtare, konkludojnë se 1 në 10 europianë nuk mund të sigurojnë ngrohjen e duhur në shtëpitë e tyre në dimër e po ashtu 1 në 5 nuk mund të sigurojnë ftohjen në mënyrën e duhur në shtëpinë e tyre gjatë verës. Mbi 50 milion europianë nuk mund të sigurojnë ngrohjen apo ftohjen e duhur në shtëpitë e tyre apo gjenden me strehim të papërshtatshëm e lidhur kjo me 100,000 vdekje të parakohshme në vit.

- Pjesa e të ardhurave që familjet me të ardhura të ulëta i kushtojnë furnizimit me energji është dyfishuar që nga viti 2000.
- Barra ekonomike e strehimit joadekuate arrin në mbi 194 miliardë euro në vit në kostot e shëndetit publik.
- Në Europë, ndërtesat përbëjnë rreth 40% të të gjithë energjisë së konsumuar dhe 36% e emetimeve të gazrave serrë.
- Më shumë se shtatë nga dhjetë ndërtesa janë në kushtet e mungesës së efieciencës së energjisë.
- Për çdo rritje prej 1% të objektivave të efieciencës së energjisë, 7 milionë njerëz mund të hiqen nga varfëria e energjisë.

Shtetet anëtare kanë ndërmarrë një sërë masash sic evidentohet më tej në këtë studim por ende ka shumë punë për të bërë për të siguruar që varfëria energjitike të trajtohet në politika dhe programe financimi.

¹ European Commission study 2019, HEAL 2019, Eurostat 2019, BPIE 2019


Komisioni European kohët e fundit miratoi paketën Fit for '55', për të arritur objektivat e klimës së vitit 2030 të BE-së. Fit reflekton qëllimin për të reduktuar emetimet neto nga të paktën 55% deri në vitin 2030 krahasuar me vitin 1990. Legjislacioni i ri komisionit të BE-së përfshin masa të rëndësishme për të forcuar ligjet e eficiencës së energjisë, për të ndihmuar në trajtimin e varfërisë së energjisë.

2 Varfëria energjike dhe konsumatorëve në nevojë në Palët Kontraktore të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Në studimin e Energy Community -Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties ndër të tjera evidentohet se varfëria energjike:

- Ekziston në gjashtë palë kontraktuese të komunitetit të energjisë: Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, Moldavi, Mali i Zi, Serbi.
- Në Moldavi, është adresuar në akte që nuk lidhen drejtëpërdrejtë me energjinë.
- Megjithatë, në të gjitha Palë Kontraktuese të komunitetit të energjisë, disa kategori të konsumatorëve mbrohen në lidhje me energjinë²

Normat e varfërisë së energjisë në Komunitetin e Energjisë janë ndër më të lartat në Europë. Kjo vjen për shkak të faktorëve historikë, ekonomikë dhe infrastrukturor, shoqëruar me reformat e sektorit energjistik gjatë tranzicionit pas komunizmit. Varfëria e energjisë u



përkeqësua më tej nga pandemia COVID-19, duke çuar në rritjen e papunësisë, reduktimin e të ardhurave të familjeve dhe rritjen e kërkesës për energji në rajon, të gjithë faktorë këto që kontribuojnë në varfërinë energjike. Çdo palë kontraktuese ka detyrimin të përcaktojë konceptin e konsumatorëve në nevojë që mund t'i referohen varfërisë energjike dhe, ndër të tjera, ndalimit të ndërprerjes së energjisë elektrike/gazit ndaj konsumatorëve të tillë në kohë kritike" dhe po ashtu "të marrin masat e duhura, të tilla si formulimi i planeve kombëtare të veprimit të energjisë, ofrimi i përfitimeve në sistemet e sigurimeve shoqërore për të siguruar furnizimin e nevojshëm me energji elektrike/gaz për konsumatorët vulnerabël, ose sigurimin e mbështetjes për përmirësimet e efektshmërisë së energjisë, për të trajtuar varfërinë energjike atje ku identifikohet, duke përfshirë në kontekstin më të gjerë të varfërisë. Këto masa duhet të mos pengojnë hapjen efektive të tregut. Nga studimi i Energy Community të gjithë Palet kontraktuese kanë përkufizime të konsumatorëve vulnerabël dhe se përkufizimet janë të lidhura ngushtë me konceptin social (të ardhurat) dhe gjendjen shëndetësore. Me fjalë

² Energy Community -Study on Addressing Energy Poverty in the Energy Community Contracting Parties

të tjera, statusi i një klienti në nevojë u jepet në parim konsumatorëve që përmbushin disa kriteret sociale dhe shëndetësore. Aspekte të tjera që nxisin varfërinë energjitike, të tilla si efektshmëria energjitike e shtëpive, gjinia dhe nevojat e energjisë, nuk konsiderohen. Për të siguruar që palët kontraktuese të mbrojnë të gjitha familjet subjekt i varfërisë energjitike, është propozuar që të gjithë palët kontraktuese të miratojnë një përkufizim të varfërisë energjitike. Në analizën e Komunitetit të Energjisë evidentohen institucionet kyç të përfshira në mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, së bashku me politikat ekzistuese që synojnë t'u japin atyre mbështetje. Analiza zbulon se të gjithë palët e komunitetit (me përjashtim të Maqedonisë së Veriut 229) zbatojnë vetëm masat mbështetëse të të ardhurave si mjeti kryesor për të ndihmuar konsumatorët vulnerabël, një mekanizëm kyç që mund të reduktojë përkohësisht barrën e varfërisë energjitike, por masa të tilla nuk heqin shkaqet kryesore të saj.

Siç cituar dhe më parë, mbështetja e klientëve në nevojë përfshin dy lloje mbështetjesh atë ekonomike dhe joekonomike. Mbështetja ekonomike realizohet përmes skemës së tarifave të veçanta apo përmes mbështetjes buxhetore në faturën e energjisë, sikurse edhe në rastin e Shqipërisë. Mbështetja joekonomike përfshin mosndërprerjen e furnizimit kryesisht për konsumatorët me kushte shëndetësore të vështira. Institucionet kyç të përfshira në mekanizmat e mbështetjes për klientët në nevojë përfshijnë institucionet qëndrore, ministrinë, agjensitë rregullatore, dhe pushtetin vendor.

3. Faktorët që ndikojnë në vlerësimin e varfërisë energjitike.

Varfëria energjitike është një kombinim i shumë faktorëve (siç është statusi i punësimit, shëndeti, të ardhurat ekonomike, shtrirja e mbështetjes publike, etj.), kostoja për të mbajtur një shtëpi të ngrohtë mund të jetë një kontribues në varfërinë energjitike (sidomos për familjet me të ardhura të ulëta).

Më konkretisht, varfëria energjitike ndikon dhe ndikohet nga disa aspekte shoqërore dhe teknike. Në studimin *Tackling energy poverty and enhancing energy poverty in non-profit organization* evidentohet faktorët/ aspektet që shkaktojnë apo ndikojnë në varfërinë energjitike të ndarë në:

Aspekte shoqërore

- Shëndeti

Një shtëpi që nuk është ngrohur në mënyrë të pershtatshme mund të çojë në probleme të shëndetit të tillë si në sistemin e frymëmarrjes, qarkullimit dhe kardiovaskulare, si dhe në shëndetin mendor dhe mirëqenien në afat të gjatë. Studimet kanë treguar se familjet e varfra kanë më shumë gjasa të përdorin shërbime mjekësore. Dhe fëmijët në familje të tilla kanë më shumë gjasa për të vizituar një mjek ose qëndër spitalore të kujdesit parësor (Lidell 2008, Thomson 2011).

- Edukimi

Një element tjetër i lidhur me cilësinë e jetës është edhe arsimi i cili ka ndikim afatgjatë në shkrim-leximin dhe përfshirjen sociale, duke rritur kështu mundësitë e punësimit, duke rritur kështu cilësinë e përgjithshme të jetës. Aksesit në opsionet moderne, për energji të pastër dhe të përbalueshme mund të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më miqësor për fëmijët që inkurajon ndjekjen e shkollës dhe zvogëlon normat e braktisjes.

Nga ana tjetër investimi në pronat me qera është më i vështirë pasi pronarët e pronave shohin përmirësimin e kushteve të shëndetshme të shtëpive thjesht si një kosto, pasi ato nuk përfitojnë nga faturat e energjisë së lirë, duke nënkuptuar një mosveprim të drejtë zbatimit të veprimeve të nevojshme të efikasitetit të energjisë.

- *Elementi gjinor*

Për shkak të të ardhurave mesatare të tyre më të ulëta, gratë janë në rrezik më të madh të varfërisë së energjisë sesa meshkujt. Si në vendet në organizimin për bashkëpunim ekonomik dhe zhvillim (OECD) dhe vendet jo-OECD, gratë vazhdojnë të jenë në disavantazh krahasuar me burrat në aspektin e kushteve të punësimit, përfaqësimit në organet qeverisëse dhe institucionet vendimmarrëse dhe ekspozimin ndaj roleve të papaguara.

- *Pandemia Covid 19*

Në varfërinë energjitike një element i shtuar është edhe ndikimi i Covid-19. Numri i familjeve të varfëra pritet të rritet për shkak të Covid-19, që pati impakt edhe në varfërinë energjitike, gjë që përforcoi pabarazitë në drejtim të banesave, shëndetit, punës dhe varësisë nga transporti publik.

Përveç kësaj, për shkak të pranisë më të madhe (të detyruar) në shtëpi, u rrit konsumimi i energjisë elektrike dhe ngrohjes / ftohjes i cili ndikoi në pagimin e faturave, me pasoja më të larta për familjet më vulnerabël, duke zgjedhur mes nevojave të tyre themelore, si aksesit në energji ose ushqim.

Gjatë gjendjes së alarmit të Covid 19, shtetet anëtare të BE-së zbatuan masat përkatëse në lidhje me të drejtën e energjisë dhe garancinë e furnizimeve bazë.

Aspektet teknike

Eficientia e energjisë në ndërtesa është një aspekt teknik që gjithashtu impakton në varfërinë energjitike.

Përveç mbështetjes ekonomike në financimin e rinovimit të mundshëm për të rritur efikasitetin e energjisë, aspekte të tjera të efikasitetit në ndërtesa janë edhe mbështetja në të gjitha fazat e planifikimit, financimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve të cilat duhet të marrin në konsideratë edhe marrjen e informacionit të duhur në lidhje me:

• **Struktura Origjina:** Informacion mbi strukturën e ndërtesës nga koha e ndërtimit deri në datën e vlerësimit dhe përfshinë ndërhyrjet që kanë ndryshuar strukturën. Ngjarje që kanë dëmtuar pjesërisht ose tërësisht ndërtimin dhe përdorimit të synuar të ndërtesës me kalimin e kohës.

• **Origjina e energjisë:** Ofrimi i informacionit mbi instalimet e energjisë të cilat mund të nxirren nga burime strukturore, faturat e energjisë etj.

Për të kryer zgjidhjen e duhur mjetet që përdoren kryesisht konsistojnë në:

Auditimi i energjisë: Është një mjet që kërkon njohuri dhe aktivitete dokumentare në vend.

Certifikata e Performancës së Energjisë (CPE): Mund të jetë e dobishme gjatë shqyrtimit paraprak të situatës së energjisë të ndërtesës.

Informacioni i ofruar nga CPE, ndryshe nga Auditimi i energjisë, nuk lidhet me kushtet aktuale të përdorimit të ndërtesës dhe as konsumit të energjisë të rezultuar nga faturat, por tregon performancën e energjisë në ndërtesë sipas kushteve "ideale" të përdorimit (Ndërhyrja standarde e Eficiencës së Energjisë).

Disa nga ndërhyrjet kryesore të eficiencës së energjisë që mund të ndërmerren në një ndërtesë përfshijnë:

- Izolimi termik i çatisë dhe mureve të jashtme.
- Zëvendësimi i dritareve.
- Zëvendësimi i bojlerit
- Panelet diellore në çati për prodhimin e ujit të nxehtë.
- Zëvendësimi i paisjeve të ndriçimit me dritat LED.

Cenueshmëria e energjisë në vendet e Komunitetit të Energjisë

Familjet në kushtet e varfërisë energjitike, janë një target grup heterogjen. Familjet ekonomikisht të cenueshme dhe/ose të pafavorizuara shpesh përballen me një kombinim të të ardhurave të nivelit të ulët stanjues, rritjes së çmimeve të karburantit dhe energjisë elektrike, si dhe shtëpive dhe pajisjeve teknike që nuk janë efikase për energjinë. Së bashku me problemet e tjera individuale (p.sh. arsimit i dobët, çështjet e shëndetit mendor dhe/ose fizik) dhe shtytësit strukturorë (p.sh. barrierat rregullatore për ndërrimin e furnizuesve) kjo mund të çojë në mbi-borxh dhe varfëri energjitike. Kush është më i prekur nga varfëria/vulnerabiliteti energjetik? Familjet që marrin përfitime sociale, individ me të ardhura të ulta, prindërit e vetëm dhe pensionistët janë ndër grupet më të cenueshme me shkallën e rrezikut të varfërisë që është dukshëm mbi mesataren.

Në kategorinë e familjeve në kushtet e varfërisë energjitike mund të përfshihen njerëz me përfitime sociale, ose që jetojnë në kushte të pasigurta socio-ekonomike, për shkak të kushteve

të pasigurta të punës si punë me kohë të pjesshme, kontrata të kufizuara / të përkohshme, mbrojtje e ulët / pa mbrojtje kundër pushimit nga puna, të ardhura të ulëta (d.m.th. pa përfitime sociale) dhe/ose rrethana individuale (p.sh. çështje shëndetësore ose paaftësi; struktura e familjes (prindër të vetëm).

Ekzistojnë dy pengesa të njohura për eficientë e energjisë që lidhen me varfërinë energjitike:

1. Stimujt e ndarë, të cilat ndodhin kur pala përgjegjëse për pagesën e faturave të energjisë (qiramarrësi) ndryshon nga pala që ndërmerr investimet kapitale për eficientë e energjisë (qiradhënësi); dhe
2. Efekti i bllokimit, kur qiramarrësit janë të mbyllur në situatën e tyre aktuale të banimit, ose ku investimet në eficientë e energjisë përmbushin barrierat ligjore ose teknike, duke minuar kështu statusin e familjeve. Shumica e politikave mbështetëse bazohen në premisën se zgjedhjet e banimit të familjeve në kushtet e varfërisë energjitike varen kryesisht nga mbështetjet financiare.

Në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, përqindja e popullsisë që nuk mund të përballojë komoditetin e duhur të ngrohjes është edhe më e lartë, duke filluar nga 9.5% në Serbi në 35.8% në Shqipëri. Pandemia e COVID-19 dhe pushtimi rus i Ukrainës ndikuan në tregjet e energjisë në një mënyrë të paprecedentë, duke përforcuar rritjen dramatike të çmimeve të energjisë dhe shqetësimet për furnizimin me energji. Çmimet e larta të energjisë dhe inflacioni në rritje, i cili po shkakton rënien e të ardhurave reale të familjeve, pritet të rrisë ndjeshëm numrin e familjeve në kushte të varfërisë energjitike dhe të përkeqësojë standardin e tyre të jetesës. Në studimin e Energy Community evidentohet se pasojat mund të jenë veçanërisht të dhimbshme për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Planifikimi i informuar, masat efikase dhe efektive në përputhje me objektivat e tranzicionit energjetik dhe monitorimi i ngushtë i zbatimit nevojiten më shumë se kurrë për të zbutur varfërinë energjitike.



Pasqyrë e gjendjes së **konsumit familjar**

Përqindjet ndaj totalit të konsumit real për frymë sipas rajonit

Percentage of real consumption per capita by region

(%)

| | Për ushqim | Për konsum jo-ushqimor | Për shërbimet bazë | Për edukim | Për pajisjet afatgjatë | |
|-----------------|-------------|------------------------|--------------------|------------|------------------------|---------------|
| | Food | Non-food | Utilities | Education | Durables | |
| Rajoni | 2002 | | | | | Region |
| Bregdetar | 62.8 | 21.3 | 12.3 | 2.5 | 1.2 | Coastal |
| Qëndror | 66.6 | 17.4 | 12.8 | 2.1 | 1.2 | Central |
| Malor | 66.1 | 20.5 | 9.6 | 2.9 | 0.9 | Mountain |
| Tirana | 59.5 | 21.4 | 15.6 | 2.2 | 1.4 | Tirana |
| Gjithsej | 64.5 | 19.4 | 12.6 | 2.3 | 1.2 | Total |
| Rajoni | 2005 | | | | | Region |
| Bregdetar | 57.8 | 25.2 | 13.2 | 2.8 | 1.1 | Coastal |
| Qëndror | 62.2 | 22.8 | 12.0 | 2.2 | 0.7 | Central |
| Malor | 59.9 | 26.8 | 10.3 | 2.3 | 0.8 | Mountain |
| Tirana | 53.6 | 26.4 | 15.4 | 3.6 | 1.0 | Tirana |
| Gjithsej | 59.2 | 24.5 | 12.7 | 2.7 | 0.9 | Total |
| Rajoni | 2008 | | | | | Region |
| Bregdetar | 58.9 | 21.3 | 14.5 | 4.8 | 0.5 | Coastal |
| Qëndror | 60.2 | 22.1 | 14.5 | 2.8 | 0.5 | Central |
| Malor | 59.1 | 22.1 | 13.8 | 4.5 | 0.6 | Mountain |
| Tirana | 48.9 | 27.5 | 19.1 | 4.0 | 0.6 | Tirana |
| Gjithsej | 57.7 | 22.7 | 15.2 | 3.8 | 0.5 | Total |
| Rajoni | 2012 | | | | | Region |
| Bregdetar | 58.9 | 20.3 | 17.0 | 3.2 | 0.6 | Coastal |
| Qëndror | 60.7 | 18.5 | 16.7 | 3.5 | 0.6 | Central |
| Malor | 57.9 | 20.9 | 16.0 | 4.7 | 0.5 | Mountain |
| Tirana | 52.7 | 22.4 | 21.0 | 3.1 | 0.7 | Tirana |
| Gjithsej | 58.4 | 20.0 | 17.6 | 3.4 | 0.6 | Total |

Burimi: Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, AMNJ 2002, 2005*, 2008*, 2012*

*Pas publikimit të shifrave të plota të popullsisë për vitet 2001-2014 në maj 2014, është rishikuar seria kohore e të dhënave të AMNJ 2005, 2008, 2012.

Referuar të dhënave të publikuara nga Instat rezultojnë se pesha specifike që zënë utilitetet (energji+uj) në shpenzimet familjare në shqipëri shkon në masën nga rreth 12% në atë 17% në vitin 2012, ç'ka zë një peshë të vogël krahasuar me rreth 60 % që zënë shpenzimet për ushqim. Pavarësisht sa më sipër, vlerat e mësipërme duhen pare në mënyrë krahasimore me të ardhurat të cilat po sipas instat rezultojnë si vijon :

| | | |
|--|--------|------|
| Shpenzimet mesatare mujore për konsum të familjeve shqiptare | 84.547 | lekë |
| Të ardhurat mesatare mujore për frymë/ të ekuivalentuara | 30.962 | lekë |

Vlerat krahasimore të të ardhurave mesatare, me shpenzimet mesatare për frymë, duke vlerësuar peshën që zënë shpenzimet për ushqimin në buxhetin familjar, vendosin në kushtet e ekspozimit të familjeve me të ardhura të ulëta drejt pamundësisë për të grantuar këtë mall jetësor e të domosdoshëm siç është energjia.

Numri mesatar i familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike deri në fund të vitit 2021, sipas të dhënave të instat, rezulton në masën 67.956 janë familjarë. Referuar Instat, shpenzimet për energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira të paguar dhe riparime të vogla, zënë një vlerë mesatare mujore të shpenzimeve prej 8.496 lekë, ç'ka përbën 10,0 % të totalit të buxhetit familjar.

4 Krijimi i observatorit të varfërisë energjitike të Bashkimit European dhe Energy Advisory Hub.

Në kuadër të nismave për adresimin e varfërisë energjitike, Komisioni European financoi Projektin EPOV i cili zbatohet nga një konsorcium prej 13 organizatash, duke përfshirë universitetet, grupet e këshillimit, grupet e analistëve dhe sektorin e biznesit. Observatori i Varferise së Energjisë (EPOV) i BE-së është një nismë nga Komisioni European për të ndihmuar vendet anëtare në përpjekjet e tyre për të luftuar varfërinë energjitike. Ky observator ekziston për të përmirësuar monitorimin, mbikqyrjen dhe ndarjen e njohurive dhe praktikën më të mirë mbi varfërinë energjitike. Observatori i Varfërisë së Energjisë i BE-së vepron si një shpërndarës informacioni, nismash, politikash dhe të interesuarish që veprojnë në këtë fushë dhe përpiqet të trajtojë fenomenin e varfërisë energjitike së bashku me pasojat e tij anembanë Europës. Ai ofron burime arsimore dhe lidhje me autoritetet lokale si dhe një seri rrjetesh për matjen dhe mbikqyrjen e problemit. Për herë të parë jepet një tablo krahasuese dhe e detajuar e "simptomave" të varfërisë së energjisë, siç manifestohen në secilin vend anëtar të Bashkimit European. Roli i tij kryesor është të shërbejë si një pikë referimi në të cilën vendim-marrësit dhe aktivistët mund të kenë qasje dhe të ndajnë njohuritë mbi varfërinë energjitike. Për këtë qëllim, Observatori mund të hartojë strategji për të luftuar varfërinë energjitike në nivel europian.

Observatori i Varfërisë së Energjisë i BE-së është një nismë e nisur nga Komisioni European në dhjetor të vitit 2016 dhe platforma e tij web është në dispozicion që nga janari 2018. Roli i tij kryesor është zbatimi i politikave të deklaruara në "Paketën e Energjisë së Pastër për të gjithë Europeanët" që nënkupton se sa vendimtare për zhvillimet e varfërisë së Komenergjisë Europiane në nivelet Europiane dhe kombëtare 15 mision është mbrojtja e konsumatorëve , veçanërisht ato të pambrojtur. Kjo bëhet edhe më e dukshme kur shqyrtohet evolucioni i shpejtë i tregut të energjisë. Në të njëjtën kohë, Observatori thekson nevojën për t'u thelluar në problemin e varfërisë energjitike me qëllim që të përgatitet dhe të zhvillohen strategji efektive për të luftuar atë në nivelet pan-Europiane, kombëtare dhe lokale. Të dhënat dhe informacionet e disponueshme në platformën web të Observatorit të Varferise së Energjisë të BE-së nuk kanë të bëjnë vetëm me politikën dhe vendimmarrësit, por gjithashtu i bëjnë thirrje publikut në përpjekje për të shpërndarë konfuzionin që rrethon rrënjët e problemit, përcaktimin e tij (cilësor, sasi dhe gjeografik), praktikën dhe politikën më të mira për ta luftuar atë dhe në fund

lidhjen e tij me politikat e tjera (për shembull, politika klimatike, politika e cilësisë së ajrit, shëndeti publik etj.). Observatori është pika qendrore e njohurive dhe të dhënave deri kohët e fundit të shpërndara dhe cka është shumë e rëndësishme ajo lehtëson barrierat dhe mundëson zhvillimin e aftësive nëpërmjet burimeve arsimore dhe ofrimin e ndihmës teknike.

Observatori i BE-së për Varfërinë e Energjisë (EPOV), ishte projekti paraardhës i Qendrës Këshilluese për Varfërinë e Energjisë. (**Energy Poverty Advisory Hub**). Dhe aktualisht integruar brenda EHAB. Misioni i EPAH është të jetë platforma qendrore e ekspertizës së varfërisë energjitike në Europë për autoritetet lokale dhe të gjithë lojtarët e interesuar në marrjen e veprimit për të luftuar varfërinë energjitike në Europë duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë, trajnime online dhe rezultate kërkimore dhe duke ndërtuar një rrjet bashkëpunues të palëve të interesuara në marrjen e masave për të luftuar varfërinë energjitike në Evropë. EPAH aktualisht ka realizuar publikimin e një sërë manualesh udhëzuese praktikë për qeveritë lokale dhe praktikuesit që sigurojnë që dimensionet sociale të tranzicionit të energjisë të trajtohen në mënyrë të efektshme. Kjo seri përbëhet nga:

- The "Introduction to the EPAH Handbooks: A Guide to Understanding and Addressing Energy Poverty" ;

- "Manuali 1 i EPAH : Një udhëzues për Diagnozen e varfërisë së energjisë" e cila fokusohet në vlerësimin praktik të varfërisë së energjisë në nivel lokal

- "Manuali 2 i EPAH: Një udhëzues për planifikimin e veprimeve për zbutjen e varfërisë së energjisë" i cili ofron informacion se si të përgatitet dhe integrohet një plani zbutjeje e varfërisë në energji brenda Planit Lokal Social të Klimës ▸ "Manuali 3 i EPAH: Një Udhëzues për Zbatimin e Veprimeve të Zvogëlimit të Varfërisë së Energjisë" i cili ofron informacion mbi ekzekutimin e një projekti efektiv të varfërisë energjitike.

Këto manuale shërbejnë si një udhëzues për të kuptuar më mirë fenomenin e varfërisë energjitike në nivelin lokal dhe qëndor për të shtyrë në ndryshime konkrete.

5. Monitorimi i Varfërisë Energjitike

Në studimin e DG ENER – ENER/B3/507-2015 "Selecting Indicators to Measure Energy Poverty", evidentohet se ka një divergencë në qasjen ndaj problemit të varfërisë Energjitike.

Ky diversitet në qasje pasqyron qasje të ndryshme të ndërmarra anembanë BE-së, metrike të bazuara në shpenzime. Treguesit e bazuar në shpenzimet për varfërinë energjitike rrjedhin nga niveli i shpenzimeve në energji. Ato mund të përcaktohen si përqindje e të ardhurave ose në terma absolutë. Në praktikë, vlerësimi i varfërisë së energjisë konsiston në krahasimin e metrikës së shpenzimeve (pjesa e shpenzimeve të energjisë në krahasim me të ardhurat ose shpenzimet absolute në terma monetarë) me një prag normativ. Një familje mund të konsiderohet kështu e varfër në energji nëse niveli i saj i shpenzimeve është shumë i lartë (mbi një prag të caktuar) ose shumë i ulët (nën një prag të caktuar).

Tre lloje metrikësh që përdorin pragjet mund të dallohen.

1. Pjesa e lartë e kostos së energjisë metrike që i referohet atyre që kapin familjet që kanë mbi normat e modeleve të shpenzimeve të energjisë. Prandaj, ajo i konsideron familjet si të varfëra në energji ku kostot e energjisë (si pjesë e të ardhurave ose në terma absolutë) shtrihen mbi një prag të caktuar.

2. Matës të ulët të të ardhurave në dispozicion të cilat klasifikojnë si energji të varfëra ato familje që kanë pak të ardhura të mbetura pas kostos së tyre të energjisë. Këto matësia kapin familjet, të ardhurat e disponueshme të të cilave, pas kostos së energjisë, gjenden nën një prag të caktuar.

3. Metrikë të pamjaftueshëm të shpenzimit të energjisë që shikon vetëm shpenzimet e energjisë, duke e krahasuar atë me një nivel minimal që konsiderohet i nevojshëm për një familje për të gëzuar shërbimet bazë.

Këto metrikë i klasifikojnë si subjekte të varërisë energjitike, ato familje, kostot e energjisë së të cilave janë nën një prag të caktuar. Ky është koncepti kyç i HEP, i llogaritur në Barometrin Belg të Varfërisë së Energjisë (KBF 2015). Në Barometrin e Varfërisë pragu për të përcaktuar nëse shpenzimi i energjisë ishte "anormalisht i ulët" bazohej në modelet e konsumit të të ardhurave dhe çfarë do të ishte shpenzimi i mjaftueshëm i energjisë duke marrë parasysh numrin e njerëzve në familje dhe madhësinë e banesës". Metriket konsensuale, nga ana tjetër, janë metrikë që identifikojnë ato familje që deklarojnë të përballen me vështirësi në mënyrë që të përmbushin shërbimet bazë të energjisë ("privimi i perceptuar"). Treguesit e vetë-raportuar mund të ofrojnë një mënyrë efektive për të kuptuar varfërinë e perceptuar të energjisë. Kjo familje treguesish mund të jetë një 'backstop' ose plotësuese e treguesve të tjerë. Baza kryesore deri më sot për vlerësim.

Forca kryesore e metrikës së bazuar në shpenzimet është se ajo kap saktësisht shtrirjen e varfërisë energjitike, duke iu referuar qasjes së shpenzimeve "të kërkuara". Në përgjithësi, metrikat e bazuara në shpenzime kanë gjithashtu disa disavantazhe të mëtejshme:

Qasja nuk është e standardizuar; Metrikët nuk janë të krahasueshëm në të gjithë Shtetet Anëtare; Ata nuk mbulojnë varfërinë e fshehur të energjisë; Ata nuk i konsiderojnë kushtet e përgjithshme të jetesës dhe evolucionin e çmimeve të energjisë; dhe (ata nuk marrin parasysh nevojat aktuale të energjisë së familjeve.

Lidhur me pragjet e shpenzimeve për këto metrikë, nuk ka preferencë lidhur me pragu, pasi nivelet e të ardhurave ndryshojnë shumë në të gjithë MS dhe ndryshojnë me kalimin e kohës. Si i tillë, pragu mund të jetë i ndryshëm për grupe të ndryshme të MS. Ka një vlerë në përdorimin e pragut relativ (pra shpenzimi dy herë mesatar). Gjithashtu përdorimi i një pragu lidhur me të ardhurat minimale mund të jetë i krahasueshëm në të gjithë Shtetet anëtare. Metriket konsensuale kanë një avantazh të zbatimit më të lehtë, pasi ka një bazë të standardizuar sondazhi në të gjithë MSs (SILC). Ajo jep një vështrim të çështjeve të varfërisë energjitike, bazuar në informacionin rreth nevojave aktuale të energjisë së familjeve. Dobësitë kryesore të tij janë se është e vështirë të interpretohet për shkak të natyrës subjektive të tij, sondazhi nuk është mjaft i hollësishëm, përgjigjet mund të nënvleftësojnë varfërinë energjitike, sepse familjet nuk janë të gatshme të pranojnë se janë në një situatë të vështirë me pagesën e shërbimeve energjitike dhe kjo varet nga grupi i familjeve të zgjedhura për sondazh. Metoda e bazuar në përfundime është më pak e preferuar si matësi kryesor i varfërisë energjitike. Dobësia e saj kryesore është vështirësia e zbatimit. Është e vështirë të identifikohen qartë rezultatet e varfërisë së energjisë; për më tepër, rezultatet e lidhura me shëndetin dhe shoqërinë janë tepër të ndërlikuara për t'u matur. Gjithashtu, ka një pasiguri në lidhje me kapjen e gjendjes aktuale të çështjes, pasi ajo është përqëndruar vetëm në përfundimet dhe nuk konsideron shkaqet e varfërisë energjitike. Varfëria e fshehur energjitike mund të përfshihet me përdorimin e treguesve me bazë konsensuale, për shembull niveli i temperaturës së shtëpisë. Në vendet ku

temperaturat janë më të buta (në krahasim me mesataren kombëtare), shpenzimet e energjisë shtëpiake pritet të jenë më të ulta, por kjo nuk duhet të shihet domosdoshmërisht si një problem. Një tregues tërësor i varfërisë së fshehur energjitike është paraqitur në Barometrin Belg të Varfërisë Energjitike.

Pragu relativ për varfërinë e fshehur energjitike përcaktohet për çdo familje si gjysma e shpenzimeve të energjisë të familjeve të ngjashme me të njëjtën përbërje dhe madhësi banimi. Përfundimet e përgjithshme: Qasja e bazuar në shpenzime është ndoshta për momentin më e përshtatshme (me disa rezerva) për të matur varfërinë energjitike në të gjithë MSs, por ekspertët argumentojnë se treguesi ideal do të ishte një sasi e vlerësuar e energjisë së kërkuar, e cila zakonisht nuk është e realizueshme. Metoda konsensuale mund të përdoret për të matur edhe varfërinë energjitike, nëse cilësia e studimit do të përmirësohet. Është e rëndësishme të përfshihet treguesit mbështetës kur mat varfërinë e energjisë. Ato më të rëndësishmet janë ato të lidhura me efektshmërinë e stokut të aksioneve të energjisë dhe tregun e energjisë. Kur përdoret matësi i bazuar në shpenzimet, pragu duhet të vendoset në krahasim me shpërndarjen aktuale në MS. Është e arsyeshme të zbatohen treguesit e zgjedhur jo vetëm për familjet me të ardhura të pakta. Familjet, shpenzimet e energjisë së të cilave ishin shumë të ulëta u identifikuan duke marrë parasysh shpenzimet e energjisë të familjeve të ngjashme (përbërja e familjeve dhe madhësia e shtëpive). Pragu relativ për varfërinë e fshehur energjitike përcaktohet për çdo familje si gjysma e shpenzimeve të energjisë të familjeve të ngjashme me të njëjtën përbërje dhe madhësi banimi. Përfundimet e përgjithshme: Qasja e bazuar në shpenzime është ndoshta për momentin më e përshtatshme (me disa rezerva) për të matur varfërinë energjitike në të gjithë MSs, por ekspertët argumentojnë se treguesi ideal do të ishte një sasi e vlerësuar e energjisë së kërkuar, e cila zakonisht nuk është e realizueshme. Metoda konsensuale mund të përdoret për të matur edhe varfërinë energjitike, nëse cilësia e studimit do të përmirësohet. Është e rëndësishme të përfshihet treguesit mbështetës kur mat varfërinë energjitike. Ato më të rëndësishmet janë ato të lidhura me efektshmërinë e stokut të aksioneve të energjisë dhe tregun e energjisë. Kur përdoret matësi i bazuar në shpenzimet, pragu duhet të vendoset në krahasim me shpërndarjen aktuale në MS. Është e arsyeshme të zbatohen treguesit e zgjedhur jo vetëm për familjet me të ardhura të pakta.

6. Programet për varfërinë energjitike

Ka shumë masa të ndryshme, të gjitha të projektuara dhe zbatuara sipas situatave të ndryshme të vendit. Ato mund të kategorizohen si më poshtë:

- i) ndërhyrjet financiare afatshkurtra, për të trajtuar shqetësimet e përballeshmërisë;
- ii) mbrojtje shtesë të konsumatorit të synuara posaçërisht ndaj konsumatorëve vulnerabël, veçanërisht në tregjet e brendshme të energjisë;
- iii) masat e efektshmërisë së energjisë duke synuar problemet strukturore të varfërisë së energjisë; dhe
- iv) përmirësimin e ndërgjegjësimit të konsumatorit dhe informacionit.

Çfarë masash janë formuluar dhe si zbatohen ato është një funksion kyç i kuadrit të politikës. Demografia përfshin karakterizimin e grupeve që mund të jenë në rrezik të varfërisë energjitike

